



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORË

Nr. 6407/3 Prot

Vlorë, më 01.09.2023

SHPALLJE PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE SPECIALIST PROTOKOLLI

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

1 (një) pozicion – Specialist Protokolli në sektorin e Protokollit dhe Arkivës, kategoria e pagës IV-2.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE:

15 Shtator 2023

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR:

22 Shtator 2023

Përshkrimi i përgjithshëm i punës në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në planin strategjik të komunikimit për sistemin gjyqësor, për pozicionin Specialist Protokolli, është:

- 1- Mban protokollin e korrespondencës zyrtare, të zakonshme ose të klasifikuar, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe normative në fuqi në fushën e informimit publik, informacionit të klasifikuar dhe arkivës.
- 2- Mban dhe administron librat e dorëzimit të shkresave të korrespondencës brenda gjykatës;
- 3- Përcjell shkresat, pa vonesë pas protokollimit, kryetarit të gjykatës apo kancelarit;
- 4- Vulos me vulën e gjykatës të gjitha shkresat e nënshkruara nga kryetari i gjykatës, kancelari apo personi i autorizuar prej tyre;
- 5- Ruan me shumë kujdes dhe nën përgjegjësinë e tij vulën e gjykatës;
- 6- Kujdeset për hapjen, mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave protokollar të gjykatës, të cilat plotësohen manualisht me shkrim të qartë, të pastër e të lexueshëm dhe/ose në mënyrë elektronike;
- 7- Kujdeset për dorëzimin në arkiv të dokumenteve të protokollit të cilat kanë plotësuar kushtet për arkivim;
- 8- Mban librin e kërkesave për përsheptim, drejtuar gjyqtareve si dhe regjistrin e protokollit të brendshëm të gjykatës.
- 9- Ndan postën sipas objektit dhe personave të cilëve ju drejtohet;
- 10- Siguron hedhjen e informacioneve përkatëse të korrespondencave në regjistrat protokollar;
- 11- Kujdeset për përcjelljen pa vonesë të shkresave të gjykatës;
- 12- Informon në kohë dhe në formën e kërkuar për korrespondencat e mbërritura në gjykatë, në lidhje me problematikat të mundshme për kushtet e punës, për risqet si dhe për masat që mund të merren për të adresuar këto risqe;
- 13- Punon brenda orientimeve të dhëna nga Kancelari.

I. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brënda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të jetë diplomuar në drejtësi të paktën në nivelin “Bachelor”;
- b. Të ketë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.
- c. Të ketë njohuri shumë të mira në përdorimin e Programeve të MicrosoftËord, Excel,
- d. Të zotërojë mirë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së;
- e. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe ndërveprimi.

I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dokumentat si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
 - CV e përditësuar.
 - Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave (përfshirë dhe diplomën Bachelor, për diplomat jashtë vendit të përcillet njëhësi nga MAS)
 - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha fletët që vërtetojnë eksperiencën në punë)
 - Fotokopje e letërnjoftimit (I.D).
 - Fotokopje të çertifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
 - Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
 - Vetdeklarimit të gjëndjes gjyqësore sipas formularit tip..
 - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
 - Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
 - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e tij.
 - Kontaktet (numër telefoni dhe adresë e-mail) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
 - Vërtetim banimi.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo me e-mail në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Lagje “Hajrro Çakërr”, Rruga “Sulejman Delvina”, kodi postar 9401 nëpërmjet shërbimit postar ose në adresën elektronike kontakt.gjykataerrethitvlore@gjykata.gov.al, brënda datës **15.09.2023**

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **19.09.2023**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ [ëëë.klgj.al](http://ee.klgj.al) dhe të çdo Gjykate, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e

veçanta, si dhe datën, orën dhe vendin e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

I.4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë sipas një sistemi pikëzimi.

Kandidatët do të vlerësohen:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë.
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

I.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ [ëëë.klgj.al](http://eëë.klgj.al) dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

*Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës duke filluar nga data **26.09.2023**.*

II.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil

gjqësor janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të jetë diplomuar në drejtësi të paktën në nivelin “Bachelor”;
- b. Të ketë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.
- c. Të ketë njohuri shumë të mira në përdorimin e Programeve të MicrosoftËord, Excel,
- d. Të zotërojë mirë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së;
- e. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe ndërveprimi.

II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
- CV e përditësuar.
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave (përfshirë dhe diplomën Bachelor, për diplomat jashtë vendit të përcillet njëhësi nga MAS)
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha fletët që vërtetojnë eksperiencën në punë)
- Fotokopje e letërnjoftimit (I.D).
- Fotokopje të çertifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
- Vetdeklarimit të gjëndjes gjyqësore sipas formularit tip..
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e tij.
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë e-mail) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Vërtetim banimi.
- Vërtetim nga Gjykata
- Vërtetim nga Prokuroria

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo me e-mail në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Lagje “Hajrro Çakërr”, Rruga “Sulejman Delvina”, kodi postar 9401 nëpërmjet shërbimit postar ose në adresën elektronike kontakt.gjykataerrethitvlore@gjykata.gov.al, brënda datës **22.09.2023**

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **26.09.2023**, KLGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të çdo Gjykate listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a. Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- b. Ligji 9154, datë 06.11.2003 “për Arkivat”, i ndryshuar
- c. Ligji 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
- d. Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “ Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- e. Ligji 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”
- f. Ligji Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- g. Ligji nr.152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;
- h. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor eëë.klgj.al dhe të Gjykatës.

KËSHILLI I GJYKATES SË SHKALLËS SË PARË I JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORË

- *V.O.:Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare të tij eëë.klgj.al*